



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
Qeveria – Vlada – Government  
Ministria e Punëve të Brendshme  
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova  
Ministry of Internal Affairs  
**Policia e Kosovës - Policija Kosova - Kosovo Police**



# RAPORTI VJETOR I PUNËS SË POLICISË SË KOSOVËS 2023



## PLAN I DREJTIMIT

04.

Lista e shkurtesave

05.

Mesazhi i drejtorit të  
Përgjithshëm të Policisë

07.

Përmbledhje ekzekutive

09.

Siguria, rendi dhe qetësia  
publike

12.

Siguria në trafikun rrugor

14.

Policimi në bashkësi

15.

Parandalimi dhe luftimi i  
krimit të organizuar

22.

Shërbimet Mbështetëse

24.

Bashkëpunimi me  
publikun

# POLICIA E KOSOVËS

|                                             |                                                                                                                                                                                      |
|---------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Titulli i raportit:                         | <b>Raporti vjetor i punës së Policisë së Kosovës</b><br>Janar - Dhjetor 2023                                                                                                         |
| Përpiluesi:                                 | <b>Toger Fahrije LUTFIU</b><br>Sektori për Planifikim Strategjik, Drejtoria<br>për Planifikim Strategjik dhe Çështje Ligjore                                                         |
| Aprovon:                                    | <b>Kolonel Riza SHILLOVA</b><br>Drejtör i Drejtorisë për Planifikim Strategjik dhe<br>Çështje Ligjore<br><br><b>Kolonel Fehmi HOTI</b><br>Zëvendës drejtör i Përgjithshëm i Policisë |
| Autorizon:                                  | <b>Kolonel Gazmend HOXHA</b><br>Drejtör i Përgjithshëm i Policisë së Republikës së Kosovës                                                                                           |
| Lektor:                                     | <b>Drejtoria për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun</b><br>Drejtoria e Përgjithshme e Policisë                                                                                     |
| Përkthim në<br>gjuhën angleze<br>dhe serbe: | <b>Sektori i përkthimeve</b><br>Drejtoria e Përgjithshme e Policisë                                                                                                                  |
| Dizajni grafik:                             | <b>Çajup KAJTAZI</b><br>Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun<br>Drejtoria e Përgjithshme e Policisë                                                                         |

## Policia e Republikës së Kosovës



[www.kosovopolicice.com](http://www.kosovopolicice.com)



[www.facebook.com/KosovoPolice](https://www.facebook.com/KosovoPolice)



[twitter.com/Kosovo\\_Police](https://twitter.com/Kosovo_Police)



[info@kosovopolicice.com](mailto:info@kosovopolicice.com)



Aplikacioni lajmëro Policinë

## LISTA E SHKURTESAVE

|        |                                                                     |
|--------|---------------------------------------------------------------------|
| BIMS   | Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Kufijve                         |
| DIMP   | Drejtoria për informim dhe marrëdhënie me publikun                  |
| DSHSH  | Drejtoria e Shërbimeve Shëndetësore                                 |
| MIK    | Menaxhimi i Integruar i Kufirit                                     |
| NJSI   | Njësia Speciale Intervenuese                                        |
| NJSO   | Njësia Speciale Operative                                           |
| NJMA   | Njësia e Mbrojtjes së Afërt                                         |
| PK     | Policia e Kosovës                                                   |
| PRIMS  | Sistemi informativ i Menaxhimit të Resurseve të Policisë së Kosovës |
| RKS    | Republika e Kosovës                                                 |
| SP     | Stacioni Policor                                                    |
| SHSKUK | Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës                      |
| QKTGJ  | Qendra Kombëtare për Transfuzionin e Gjakut                         |
| QNJS   | Qendra e Njësive Speciale                                           |



## MESAZHI I DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË POLICISË



**Kolonel**

**Gazmend HOXHA**

Drejtor i Përgjithshëm i Policisë  
së Republikës së Kosovës

*Në kuadër të aktiviteteve policore të orientuara në parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar, krimeve të rënda, krimit ekonomik dhe korrupsionit, terrorizmit, ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit, janë realizuar shumë operacione, plane operative, kontrolle dhe janë arrestuar shumë të dyshuar të përfshirë në aktivitete të tilla kriminale.*

Raporti vjetor i punës së Policisë së Kosovës për vitin 2023 paraqet arritjet e përgjithshme dhe të veçanta të Policisë së Kosovës në përmbushjen e objektivave strategjike, specifike por edhe të aktiviteteve të parapara për vitin e kaluar.

Nga të dhënat e prezantuara në këtë raport, rezultatet dhe të arriturat e përgjithshme tregojnë përkushtimin e organizatës sonë por edhe secilit individ në realizimin e planit të punës së Policisë.

Viti që lëmë pas ka qenë një vit mjaft sfidues për Policinë e Kosovës dhe për Kosovën në përgjithësi sa i përket sigurisë në përgjithësi, rendit publik dhe sigurisë shtetërore. Sfidat me të cilat jemi përballur gjatë vitit 2023 ndonëse ishin të mëdha, vërtetuan se Policia e Kosovës është e gatshme dhe e përgatitur për t'u përballur me të gjitha rreziqet dhe kërcënimet ndaj rendit publik dhe sigurisë së vendit në përgjithësi.

Gjatë vitit të kaluar ne kemi pasur si objektiva kryesore zbatimin e ligjit në mënyrë efikase dhe efektive, parandalimin dhe luftimin e të gjitha formave të kriminalitetit, mbikëqyrjen dhe kontrollin efikas të kufirit shtetëror si dhe ofrimin e shërbimeve për qytetarët.

Siguria e përgjithshme në Kosovë, gjatë vitit 2023, ka qenë e qetë, në përjashtim të territorit të tri komunave veriore të Kosovës, ku në vazhdimësi ka qenë e brishtë dhe e cenuar nga sulmet e strukturave ilegale dhe grupeve terroriste në veçanti gjatë vitit që lëmë pas jemi përballuar me protestat dhe sulmet e dhunshme nga grupet dhe strukturat kriminale si dhe grupet terroriste të cilat sulmuan Policinë e Kosovës, KFOR-in, gazetarët, qytetarët si dhe duke shkatërruar pronën e tyre, kidnapimin e zyrtarëve policorë në detyrë nga formacione të ardhura nga Serbia si dhe kërcënimet dhe djegiet e pronës së qytetarëve në veri.

Këto tentativa kishin për qëllim cenimin e rendit dhe sigurinë publike me aktivitete, duke penguar zbatimin e ligjit në mënyrë të drejtë dhe të barabartë për të gjithë qytetarët. Në këtë kontekst, e arritura më e madhe nga Policia e Kosovës është menaxhimi i sulmit terrorist në fshatin Banjskë të komunës së Zveçanit, i ndodhur më datën 24.09.2023, ku si pasojë mbet i vrarë rreshteri policor Afrim Bunjaku, u plagosën 3 zyrtarë si dhe 1(një) zyrtarë policor u lëndua. Ky sulm është planifikuar dhe ekzekutuar nga grupi terrorist i përbërë prej më shumë se 70 vetë, të trajnuar, pajisur dhe financuar nga Serbia, me armatim të rëndë ushtarak si dhe pajisje të tjera. Gjatë realizmit të këtij operacioni në shkëmbim zjarri kanë mbetur të vrarë tre të dyshuar, disa janë arrestuar si dhe janë konfiskuar një sasi e madhe e armatimit dhe pajisjeve të përdorura nga grupi terrorist.

Në kuadër të aktiviteteve policore të orientuara në parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar, krimeve të rënda, krimit ekonomik dhe korrupsionit, terrorizmit, ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit, janë realizuar shumë operacione, plane operative, kontrolle dhe janë arrestuar shumë të dyshuar të përfshirë në aktivitete të tilla kriminale.

Me qëllim të ruajtjes së sigurisë publike, kontrollit dhe mbikëqyrjes së kufijve të RKS-së si dhe parandalimit dhe luftimit të krimit, Policia e Kosovës, gjatë kësaj periudhe ka trajtuar shumë vepra penale, ka arrestuar shumë persona të dyshuar për kryerjen e veprave të ndryshme kriminale, ka konfiskuar armë zjarri të llojeve të ndryshme, municione të kalibrave të ndryshëm si dhe ka konfiskuar substancë të ndryshme narkotike. Krahas këtyre aktiviteteve ne kemi ofruar edhe shumë asistime për agjencitë e ndryshme shtetërore.

Gjatë kësaj periudhe, Policia e Kosovës ka zbatuar planin taktik për identifikimin e rrugëve ilegale të cilat kryesisht janë përdorur nga grupet kriminale për kontrabandë të armëve dhe mallrave, me ç'rast është arritur që të mbyllen 23 rrugë ilegale në mes kufirit Kosovës-Serbi dhe 6 rrugë ilegale në kufirin me Malin e Zi (në koordinim me autoritetet e Malit të Zi).

Trafiku rrugor gjithashtu ka qenë njëri ndër prioritetet për vitin e kaluar, Policia e Kosovës ka hartuar dhe ka zbatuar shumë plane operative, janë shqiptuar kundërvajtje të ndryshme të trafikut rrugor si dhe ka arritur të sigurojë pajisje moderne, të funksionalizojmë projektin "kamera të trupit për zyrtarë policorë", i cili besojmë se do të japë rezultate të mira në të ardhmen.

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e ngritjen dhe zhvillimin e vazhdueshëm të burimeve njerëzore, gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar procese rekrutimi për zyrtarë policorë vetëm për komunitetet pakicë si dhe kemi zhvilluar edhe konkurs të përgjithshëm për gjeneratën e 59-të, që do të fillojë trajnimin në Janar të vitit 2024.

Policia është përkushtuar edhe në ngritjen e vetëdijesimit të qytetarëve sa iu përket rreziqeve dhe kërcënimeve për sigurinë, me ç'rast vazhdimisht kemi projektuar projekte të ndryshme të cilat janë realizuar përmes fushatave vetëdijesuese, ligjëratave në shkolla si dhe takimeve të ndryshme me komunitetin. Gjatë kësaj periudhe janë implementuar projektet me temat "Parandalimi i aksidenteve dhe sensibilizimi i pjesëmarrësve në trafikun rrugor", "Dita botërore kundër drogës", "Patrullo dhe bisedo", "Festo me zemër-jo me armë" "Iniciativa për shkolla të sigurta" "Dhuna në familje" dhe "Parandalimi i ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm".

Të gjitha aktivitetet tona janë drejtuar nga metodologjia e punës sonë, e drejtuar nga koncepti i policimit të drejtuar me inteligjencë dhe në komunitet dhe për vitin 2024 presim vazhdim dhe arritje të rezultateve edhe më të mira.

# Përmbledhje ekzekutive

Në Policinë e Kosovës janë të punësuar 8,817 punonjës, prej të cilëve 7,949 janë zyrtarë policorë, ndërsa 868 staf civilë. 85.21% e personelit të Policisë i takojnë gjinisë mashkullore, ndërsa 14.79% gjinisë femërore, prej të cilëve 90.80% janë shqiptarë, ndërsa 9.20% iu takojnë komuniteteve të tjera.

- Numri i vrasjeve ka shënuar ngritje për 38.09%;
- Numri i lëndimeve të rënda trupore ka shënuar rënie për 9.26%;
- Numri i vjedhjeve të rënda ka shënuar rënie, për 1.96%;
- Numri i rasteve të dhunës në familje ka shënuar rënie, për 10.77%.

Me qëllim të adresimit të qëndrueshëm të sfidave në trafikun rrugor, gjatë kësaj periudhe, Policia e Kosovës ka arritur dukshëm të modernizojë pajisjet e saj dhe tani njësitet përkatëse të trafikut rrugor janë në posedim të pajisjeve me teknologji bashkëkohore.

Me qëllim që të identifikohen, adresohen dhe të parandalohen sëmundjet dhe dukuritë e tjera psikomocionale në Policinë e Kosovës, gjatë kësaj periudhe ekipi mjekësor dhe Ekipi për Këshillim dhe Përkrahje i PK-së kanë mbajtur: 266 seanca psikologjike, 36 raste të reja dhe 114 rivlerësime. Gjithsej përkrahje mjekësore është ofruar për 6,911 pjesëtarë të Policisë. Në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit në mes të Policisë dhe Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës për ekzaminimin mjekësor sistematik të personelit policorë, gjatë kësaj periudhe janë ekzaminuar 1,055 zyrtarë policorë të grupmoshës 50-59 vjeçare, ndërsa janë realizuar 279 ekzaminime mjekësore dhe psikologjike në SHSKUK për verifikimin e aftësisë së punës si dhe 104 ekzaminime mjekësore të avancuara (rezonancë magnetike).

Në bashkëpunim me QKTGJ-në, është realizuar aksionin humanitar "Dhurimi vullnetar i gjakut", nëpër të gjitha drejtoritë rajonale.

Në kuadër të aktiviteteve policore të orientuara në parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar, krimeve të rënda, krimit ekonomik dhe korrupsionit, terrorizmit, ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit, është punuar në gjithsej 1,652 raste janë:

- realizuar 323 operacione;
- arrestuar 1,403 persona të dyshuar për vepra të rënda penale, ndërsa janë ndaluar 558 persona;
- bastisur & kontrolluar 881 lokale;
- paraqitur 1,184 kallëzime penale, 77 prej të cilave me kryes të panjohur, 1,107 kallëzime penale me kryes të njohur ndaj 2,106 personave; si dhe janë
- goditur 23 grupe kriminale.

Me qëllim të ngritjes së sigurisë në bashkësi dhe në përputhje me Strategjinë e Integruar të Policimit të drejtuar nga Inteligjenca dhe Policimit në Bashkësi dhe Planin e Veprimit 2022-2025, Policia ka vazhduar përkushtimin e saj në promovimin dhe ndërtimin e partneritetit me komunitetin nëpërmes një numri të madh projektesh dhe një sërë aktivitetsesh. Gjatë kësaj periudhe ka vazhduar projekti "Njihuni me policin tuaj" në Drejtoritë Rajonale. Gjatë kësaj periudhe janë implementuar projektet me temat "Parandalimi i aksidenteve dhe sensibilizimi i pjesëmarrësve në trafikun rrugor", "Dita botërore kundër drogës", "Patrollo dhe Bisedo", "Festo me zemër-jo me armë" "Iniciativa për shkolla të sigurta" "Dhuna në familje" dhe "Parandalimi i ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm".

Gjatë vitit 2023 Policia përfundoi procesin e punësimit të 864 zyrtarëve policorë, nga të cilët 108 zyrtarë i përkasin komuniteteve pakicë. Bazuar në konkursin e përgjithshëm për zyrtar policor të shpallur në korrik të vitit raportues, në proces është gjenerata e 59-të e cila do të fillojë trajnimin në AKSP gjatë muajit janar të vitit 2024 me gjithsej 450 kandidatë për zyrtarë policorë.

Me qëllim të ofrimit të sigurisë së kufijve, janë ndërmarrë: 65 operacione, 320 patrullime të përbashkëta, janë realizuar 107 raste të bashkëpunimit ndërkombëtar, 3,432 refuzime të hyrjes dhe 636 refuzime të daljes nga Republika e Kosovës. Janë shqiptuar 1,191 gjoba në fushën e qëndrimit ilegal dhe mosvazhdimin e lejes së qëndrimit.

Policia e Kosovës është vazhdimisht e përkushtuar në ngritjen dhe forcimin e bashkëpunimit me publikun, mediumet elektronike dhe të shkruara. Gjatë kësaj periudhe janë lëshuar 2,130 komunikata, janë publikuar 2,233 aktivitete policore, 365 raporte 24-orësh; revista e Policisë "Mbrojtësi".

# Përmbledhje ekzekutive



## Raste

| Viti 2022 |  | Viti 2023 |
|-----------|--|-----------|
| 49,183    |  | 50,564    |



## Vepra penale

| Viti 2022 |  | Viti 2023 |
|-----------|--|-----------|
| 29,857    |  | 28,827    |



## Persona të arrestuar

| Viti 2022 |  | Viti 2023 |
|-----------|--|-----------|
| 16,124    |  | 15,072    |



## Persona të ndaluar

| Viti 2022 |  | Viti 2023 |
|-----------|--|-----------|
| 5,630     |  | 5,297     |



## Grupe kriminale të goditura

| Viti 2022 |  | Viti 2023 |
|-----------|--|-----------|
| 34        |  | 23        |



## Armë zjarri të konfiskuara

| Viti 2022 |  | Viti 2023 |
|-----------|--|-----------|
| 1,473     |  | 1,392     |



## Municione të konfiskuara

| Viti 2022 |  | Viti 2023 |
|-----------|--|-----------|
| 29,903    |  | 37,215    |



## Persona të vdekur në trafikun rrugor

| Viti 2022 |  | Viti 2023 |
|-----------|--|-----------|
| 106       |  | 106       |



## Tiketa të shqiptuara në trafikun rrugor

| Viti 2022 |  | Viti 2023 |
|-----------|--|-----------|
| 646,790   |  | 648,646   |



## Gjopa për kundërvajtje në fushën e migrimit

| Viti 2022 |  | Viti 2023 |
|-----------|--|-----------|
| 1,311     |  | 1,191     |



## Aksidente në trafikun rrugor

| Viti 2022 |  | Viti 2023 |
|-----------|--|-----------|
| 20,792    |  | 23,676    |



## Hyrje/dalje të personave në kufi

| Viti 2022  |  | Viti 2023  |
|------------|--|------------|
| 23,264,201 |  | 27,301,856 |



## Protesta dhe tubime të qytetarëve

| Viti 2022 |  | Viti 2023 |
|-----------|--|-----------|
| 196       |  | 728       |



## Refuzimi i hyrjes në Republikën e Kosovës

| Viti 2022 |  | Viti 2023 |
|-----------|--|-----------|
| 7,261     |  | 3432      |



## Refuzimi i daljes nga Republika e Kosovës

| Viti 2022 |  | Viti 2023 |
|-----------|--|-----------|
| 708       |  | 636       |

# SIGURIA, RENDI DHE QETËSIA PUBLIKE

Policia e Kosovës si institucion i zbatimit të ligjit, fal bashkëpunimit me qytetarë, bashkëpunimit ndërinstytucional si dhe bashkëpunimit ndërkombëtarë ka arritur rezultate të konsiderueshme në luftimin e dukurive më shqetësuese të shoqërisë, përkundër sfidave të shumta të cilat janë paraqitur gjatë përmbushjeve të objektivave policore.

Gjatë periudhës raportuese, Policia e Kosovës ka evidentuar gjithsej 50,564 raste, prej të cilave 28,827 janë klasifikuar si vepra penale, ndërsa 21,737 raste janë klasifikuar si kundërvajtje dhe raste të natyrave të tjera. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022, numri i rasteve ka shënuar ngritje për 2.80%, ndërsa numri i veprave penale ka shënuar rënie për 3.44%. Numri i kundërvajtjeve dhe rasteve të natyrave të tjera kanë shënuar ngritje për 12.47%.

## **Rënie/ngritje më të dalluara janë vërejtur si në vijim:**

- Numri i vrasjeve ka shënuar ngritje, nga 21 në 29 ose ngritje për 38.09%;
- Numri i lëndimeve të rënda trupore ka shënuar rënie, nga 259 në 235, ose rënie për 9.26%;
- Numri i vjedhjeve ka shënuar ngritje, nga 4,094, në 4,164, ose ngritje për 1.70%;
- Numri i vjedhjeve të rënda ka shënuar rënie, nga 2,802 në 2,747, ose rënie për 1.96%;
- Numri i grabitjeve është 93, njëjtë sikurse në vitin 2022;
- Numri i rasteve të dhunës në familje ka shënuar rënie, nga 2,757 në 2,460, ose rënie për 10.77%.

Gjatë kësaj periudhe, si rezultat i angazhimit policor janë ndaluar 5,297 persona, për shkak të dyshimeve në përfshirje në akte kriminale, ku në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2022 është shënuar një rënie për 5.91%. Po ashtu, Policia ka arrestuar 15,072 persona, të cilët në bashkëpunim me autoritetet përkatëse janë dërguar në procedura të mëtejme. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak, vërehet një rënie e personave të arrestuar për 6.52%.

Në operacione të ndryshme të ndërmarra, Policia ka konfiskuar 1,392 armë zjarri të llojeve të ndryshme dhe në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2022 është shënuar një rënie për 6.52%, si dhe janë konfiskuar 37,215 sasi të municionit të kalibrave të ndryshëm dhe në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2022 është shënuar një ngritje për 24.45%.

Gjatë kësaj periudhe, Policia ka regjistruar gjithsej 728 protesta dhe tubime, në të cilat Policia e Kosovës ka kryer një varg të detyrave policore lidhur me këto protesta dhe tubime. Në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2022 vërehet një ngritje e protestave dhe tubimeve për 271.42%.

Përveç angazhimit policor në përmbushjen e objektivave strategjike të Policisë të parapara për vitin 2023, gjatë kësaj periudhe, Policia ka ofruar mbështetjen e saj të vazhdueshme dhe autoriteteve të tjera relevante në përmbushjen e detyrave të tyre të përcaktuara me ligj, me ç 'rast janë ofruar 7,133 asistime. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak, vërehet një rënie e ofrimit të asistencës për 2.88%.

Në veçanti në vitin 2023, për shkak të aktiviteteve të grupeve kriminale në pjesën e veriut të Kosovës, të cilët gjithashtu kanë pasur tendencë destabilizimin e situatës së sigurisë në atë pjesë, Policia e Kosovës ka ndërmarrë një mori aktivitete policore, me qëllim të parandalimit dhe luftimit të krimit, si dhe ofrimit të sigurisë së qëndrueshme, kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit. Në kuadër të këtyre aktiviteteve, policia ka zbatuar urdhrat operativ, planet operative, operacionet, në të cilat janë angazhuar operacionalisht numër i madh i zyrtarëve policorë. Gjatë zbatimit të këtyre aktiviteteve policore, nga grupet e ndryshme kriminale, njësitet policore janë sulmuar, në të cilat aktivitete të jashtëligjshme kemi pasur vrasje të rreshterit policor, plagosje dhe lëndime të zyrtarëve policorë.

Gjatë vitit 2023 janë menaxhuar disa nga rastet më të rënda sa i përket cenimit të rendit kushtetues dhe sigurisë publike në veri të vendit siç janë: Sulmi me 26 maj 2023; Sulmi me 29 maj 2023; rasti me 14 qershor 2023 ku ka ndodhur kidnapimi i 3 zyrtarëve policorë nga formacionet ushtarake policore serbe; Sulmi terrorist në Banjskë me datën 24 shtator 2023 nga grupi terrorist si dhe sulmet, kërcënimet dhe djegiet e veturave të qytetarëve në veri të vendit.






# Mbështetja nga Njësitë Speciale:

Departamenti i Njërive Speciale ka realizuar një mori aktivitete të mbështetjes me njësi në operacione të ndryshme me rrezikshmëri të lartë dhe të mesme në rastet e ndryshme të krimeve të rënda, terrorizmit, rendit kushtetues si dhe cenimin e sigurisë në përgjithësi. Në këtë kontekst ky departament gjatë vitit 2023 ka realizuar:

- 54 plane operative;
- 9,651 automjete të ndaluara/kontrolluara;
- 9,548 persona të kontrolluar/legjitimuar;
- 434 objekte të kontrolluara;
- 461 hapësirë dhe rrugë e kontrolluar;
- 46 operacione, në veçanti ( përcjellja e delegacioneve);
- 1,097 angazhime operacionale (asistim DRP-ve dhe njërive të tjera );
- 35 operacione në veçanti NJMA ( Ekstradime të jashtme dhe të brendshme);
- 36 reagimet në rastet me mjete të dyshuara shpërthyes;
- 19 operacione rutinë NJMA (përcjellja e VIP-ve vendor);
- 108 ofrimi i sigurisë fizike në objektet me rëndësi të veçantë (pika statike);
- 19 vlerësimi i rrezikshmërisë për delegacionet e huaja;
- 14 vlerësimi i rrezikshmërisë për personat me rëndësi të veçantë;
- 60 asistim SHKK-së .

Policia ka vazhduar të ofrojë siguri 24 orëshe në 158 pika statike të objekteve të rëndësishme të veçantë: diplomatike, qeveritare, policore, ministore si dhe objekteve të trashëgimisë kulturore dhe fetare ortodokse. Ndërsa për të gjitha objektet e tjera të rëndësishme të veçantë, Policia e Kosovës kujdeset me anë të patrullimeve të rregullta, ku në bazë të vlerësimeve ndërmerrë edhe aktivitete të tjera të nevojshme për sigurinë e këtyre objekteve.





# SIGURIA NË TRAFIKUN RRUGOR

Siguria në trafikun rrugor vazhdon të mbetet sfidë jo vetëm për Kosovën, por edhe për shumë shtete të Evropës dhe të botës. Për të adresuar këtë sfidë, Policia e Kosovës në vazhdimësi ka bërë përpjekje të mëdha që të ngrihet siguria në trafikun rrugor duke përdorur një qasje të ofrimit të sigurisë e cila në bërthamën e saj ka: (i) parandalimin (me metodat proaktive dhe reaktive) dhe zbulimin e të gjitha aktiviteteve që mund të ndikojnë negativisht në sigurinë e përgjithshme të trafikut rrugor, (ii) bashkërendimin dhe koordinimin e veprimeve policore, me theks të veçantë ndërmjet njësive organizative të Policisë, pastaj ato ndërinstitucionale, ndërkombëtare, shoqërisë civile si dhe ekspertëve të ndryshëm të fushës së sigurisë në trafikun rrugor në kuptimin e saj më të gjerë, e cila në bërthamën e saj gjithashtu ka edhe (iii) orientimin strategjik të adresimit të sfidave në trafikun rrugor.

Me qëllim të adresimit të qëndrueshëm të sfidave në trafikun rrugor, gjatë kësaj periudhe, Policia e Kosovës ka arritur dukshëm të modernizojë pajisjet e saj dhe tani njësitet përkatëse të trafikut rrugor janë në posedim të pajisjeve me teknologji bashkëkohore, të cilat përfshijnë: kamera në trup; vetura të reja me kompjuterë të cilët kanë qasjen në bazën e integruar të të dhënave të Policisë; radar dore për matje të shpejtësisë së mjeteve motorike të cilët mundësojnë ofrimin e dëshmive për kundërvajtje në trafikun rrugor.

Për të adresuar sfidat në trafikun rrugor, Policia e Kosovës ka hartuar dhe ka zbatuar 15 plane operative në lidhje me ofrimin e sigurisë në trafikun rrugor. Janë hartuar 106 raporte analitike dhe janë realizuar 22 inspektime të infrastrukturës rrugore, të cilat kanë qenë të orientuara në identifikimin dhe adresimin e dukurive negative në trafikun rrugor, duke përfshirë fenomenologjinë dhe etiologjinë e aksidenteve. Ka hartuar 185 raporte/shkresa në lidhje me gjendjen e infrastrukturës rrugore, të cilat janë adresuar tek institucionet përkatëse. Janë realizuar 41 takime dhe pjesëmarrje në 41 emisione/intervista dhe 20 fushata vetëdijesuese, të fokusuara në ngritjen e sigurisë në trafikun rrugor.

Në kuadër të angazhimit të Policisë në ngritjen e sigurisë në trafikun rrugor, gjatë vitit 2023 Policia ka shqiptuar 648,646 tiketa për kundërvajtje në trafikun rrugor, që në raport me vitin 2022 është shënuar ngritje për 0.32%.



### **Gjatë kësaj periudhe është vërejtur ngritje e aksidenteve në trafikun rrugor:**

- Aksidenteve në trafikun rrugor, nga 20,792 në 23,676 aksidente, apo ngritje për 13.87%;
- Aksidenteve me fatalitet, nga 95 në 96 aksidente, apo ngritje për 1.05%;
- Aksidenteve me lëndime, nga 7,755 në 8,764 aksidente, apo ngritje për 13.01%;
- Aksidenteve me dëme materiale, nga 12,941 në 14,817 aksidente, apo ngritje për 14.49%.
- 106 persona kanë humbur jetën, që në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2022 nuk ka ndonjë ndryshim;
- 16,905 persona janë lënduar, që në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2022 shënon ngritje për 14.79%.

Sa u përket aktiviteteve të Komisionit për Vendosje, lidhur me kundërshtime të parashtruara për kundërvajtjet e shqiptuara nga ana e Policisë, gjatë këtij muaji janë pranuar gjithsej 5,633 kundërshtime (ankesa), janë mbajtur gjithsej 604 seanca për shqyrtimin e kundërshtimeve dhe janë përpiluar gjithsej 5,453 vendime.

Në kuadër të angazhimeve në ngritjen e sigurisë në trafikun rrugor, gjatë kësaj periudhe janë realizuar 645 përcjellje të materieve të rrezikshme dhe 507 përcjellje të personaliteteve të rëndësishme.



# POLICIMI NË BASHKËSI

Me qëllim të ngritjes së sigurisë në bashkësi në përputhje me Strategjinë e Integruar të Policimit të drejtuar nga Inteligjenca dhe Policimit në Bashkësi dhe Planin e Veprimit 2022-2025, Policia e Kosovës ka vazhduar përkushtimin e saj në promovimin dhe ndërtimin e partneritetit me komunitetin nëpërmes një numri të madh projektsh dhe një sërë aktivitetsh. Këto nisma kanë synuar parandalimin e krimit dhe realizimin e projekteve në vetëdijesimin dhe këshillimin e nxënësve në fusha të ndryshme të dukurive negative në shoqëri.

Në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, drejtoritë komunale të arsimit dhe menaxhmentin e shkollave, në institucionet e arsimit para-universitar të Republikës së Kosovës Policia ka organizuar aktivitete parandaluese dhe ligjërata vetëdijesuese për nxënës në temat si: “Parandalimi i aksidenteve dhe sensibilizimi i pjesëmarrësve në trafikun rrugor”, “Dita botërore kundërdrogës”, “Patrullo dhe Bisedo”, “Festo me zemër-jo me armë” “Iniciativa për shkolla të sigurta” “Dhuna në familje” dhe “Parandalimi i ekstrermizmit dhe radikalizmit të dhunshëm”. Përveç ligjëratave në shkolla, Policia ka realizuar edhe një sërë projektsh me fëmijë si: “Të festojmë së bashku të ardhmen tonë-1 Qershori”, “Festojmë së bashku 2024”, Të kujdesemi për sigurinë”, “Së bashku për shkolla të sigurta”, “Puna vullnetare e të rinjve në PK” etj.





# PARANDALIMI DHE LUFTIMI I KRIMIT TË ORGANIZUAR, KRIMEVE TË RËNDA, KRIMIT EKONOMIK DHE KORRUPSIONIT, TERRORIZMIT, EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM DHE RADIKALIZMIT

Për periudhën raportuese, në kuadër të aktiviteteve policore të orientuara në parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar, krimeve të rënda, krimit ekonomik dhe korrupsionit, terrorizmit, ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit, është punuar në gjithsej 1,652 raste, prej tyre 1,041 raste të reja, 341 raste të pranuar nga njësitë e tjera në kuadër të Policisë së Kosovës, 270 raste janë bartur nga vitet paraprake. Sa i përket krahasimit të numrit të rasteve në punë me vitin 2022 tregon rënie për 4.23%;

Janë realizuar 323 operacione, që krahasuar me vitin 2022 tregon rënie për 6.91% dhe janë bastisur dhe janë kontrolluar 881 lokale, që në krahasim me vitin 2022 tregon ngritje për 8.36%;

Gjatë vitit 2023 janë arrestuar 1,403 persona të dyshuar për vepra të rënda penale, që krahasuar me vitin 2022 tregon rënie për 7.45%, ndërsa janë ndaluar 588 persona, që krahasuar me vitin 2022 tregon rënie për 9.11%.

Janë paraqitur 1,184 kallëzime penale, 77 prej të cilave me kryes të panjohur, 1,107 kallëzime penale me kryes të njohur ndaj 2,106 personave, krahasuar me vitin 2022 kemi një ngritje të kallëzimeve penale për 8.72%. Janë goditur 34 grupe kriminale që krahasuar me vitin 2022 tregon rënie për 30.61%.

Në fushën e luftimit të trafikimit me qenie njerëzore: gjatë vitit 2023 janë regjistruar 142 raste, janë arrestuar 199 persona të dyshuar dhe janë paraqitur 81 kallëzime penale ndaj 128 personave të dyshuar dhe 46 fletëparaqitje për kundërvajtje ndaj 96 personave. Prej tyre, për: a) trafikim me njerëz - janë regjistruar 17 raste; b) mundësim prostitucioni - janë iniciuar 24 raste; c) marrje me prostitucion - janë regjistruar 47 raste dhe d) për vepra të tjera të kësaj natyre - janë regjistruar 54 raste. Janë identifikuar 33 viktima të trafikimit, dhe janë asistuar 58 viktima.



Në fushën e parandalimit, hetimit dhe zbulimit të trafikimit me narkotikë: janë iniciuar gjithsej 678 raste të reja, janë arrestuar 859 persona dhe janë paraqitur 553 kallëzime penale ndaj 785 të dyshuarve. Prej tyre, për: a) trafikim- janë regjistruar 218 raste, b) posedim të drogave - 447 raste, c) kultivim 13 raste. Nga numri i përgjithshëm i rasteve, për heroinë janë iniciuar 16 raste për kokainë janë regjistruar 69 raste, për marihuanë janë iniciuar 539 raste, për kultivimin e bimëve të kanabisit janë iniciuar 12 raste ndërsa për droga të tjera janë regjistruar 17 raste.

Gjatë vitit 2023 janë konfiskuar 2 kg. 872.05 gr. heroinë; 5 kg. 466.86 gr. kokainë; 601 kg 113.45 gr. marihuanë si dhe 21,989 bimë kanabis.

Në fushën e luftimit kundër krimeve ekonomike dhe korrupsionit: janë regjistruar 348 raste, janë arrestuar 125 të dyshuar dhe janë paraqitur 330 kallëzime penale ndaj 648 personave të dyshuar. Për veprën penale: a) kundër detyrës zyrtare/korrupsionit- janë regjistruar 147 raste; b) kundër ekonomisë - 59 raste; c) kundër pasurisë- 31 raste; d) falsifikim dhe mashtrim - 53 raste; e) shpëlarje të parave- 6 raste; dhe e) vepra të tjera janë regjistruar 52 raste.

Drejtoria për Hetimin e Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda (raste e trajtuara): ka iniciuar 124 raste, arrestuar 148 persona të dyshuar dhe ka ngritur 69 kallëzime penale ndaj 278 të dyshuarve. Po ashtu janë trajtuar edhe 63 raste me hetime preliminare.

Në kuadër të Sektorit për Hetimin e Krimit të Organizuar, gjatë kësaj periudhe janë iniciuar 37 raste. Për veprën penale: a) krim i organizuar- janë regjistruar 3 raste; b) trafikim me armë - 6 raste; c) trafikim me migrantë- 5 raste; d) kontrabandim me mallra -3 raste; e) fajde- 9 raste; f) auto krime- 8 raste dhe h) për vepra të tjera të kësaj natyre janë regjistruar 3 raste.

Në kuadër të Sektorit për Hetimin e Krimeve të Rënda, gjatë kësaj periudhe janë regjistruar 87 raste. Janë arrestuar 65 persona të dyshuar dhe janë paraqitur gjithsej 45 kallëzime penale ndaj 175 persona të dyshuar.

Për veprën penale: a) kundër rendit kushtetues- janë regjistruar 2 raste; b) vrasje - 3 raste; c) kanosje- 20 raste; d) detyrim- 1 rast; e) për vepra të tjera të kësaj natyre janë regjistruar 61 raste.

Në fushën e Hetimit të Krimeve Kibernetike ka regjistruar 40 raste, janë arrestuar 29 persona të dyshuar dhe janë ngritur 37 kallëzime penale ndaj 68 personave të dyshuar.

### **Në fushën e hetimeve të integruara financiare janë trajtuar:**

Për përfitim të kundërligjshëm të pasurisë janë hetuar gjithsej 55 raste, prej tyre janë pranuar 30 raste të reja. Janë të përfunduara 17 raste dhe 38 raste mbeten nën hetime.

Janë sekuestruar: 1 shtëpi, 8 banesa, 8 lokale/garazhe, 179 parcela toke dhe 3 vetura dhe llogari.

Hetimi i krimeve të luftës janë iniciuar 14 raste, ka arrestuar 12 persona dhe ka përcjellë 22 kallëzime penale ndaj 149 personave.

Parandalimi dhe luftimi i terrorizmit- janë regjistruar 32 raste, janë arrestuar 23 persona të dyshuar dhe janë paraqitur 11 kallëzime penale ndaj 41 personave të dyshuar. Prej gjithsej 32 rasteve 18 janë regjistruar në fushën e terrorizmit dhe 14 për vepra tjera.

Njësia e Veçantë e Hetimeve ka iniciuar 4 raste, ka arrestuar 8 persona, dhe ka përcjellë 4 kallëzime penale ndaj 9 të dyshuarve. Janë pranuar nga Prokuroria 286 raste me PPN, janë përcjellë në prokurori 22 raste me PPN dhe 30 raste me PPS, të pranuar nga Prokuroria e Shtetit për të cilat janë duke u zhvilluar hetime preliminare dhe ka punuar në 29 raste të bartura nga viti paraprak. Hetime preliminare janë zhvilluar për 41 informata.

Kundër detyrës zyrtare/korrupsion janë regjistruar 4 raste, janë arrestuar 5 persona dhe janë përcjellë 4 kallëzime penale ndaj 9 personave të dyshuar.





# KONTROLLI, MBIKËQYRJA DHE MENAXHIMI I INTEGRUAR I KUFIRIT

Policia ka treguar një përkushtim të veçantë edhe në fushën e kontrollit dhe mbikëqyrjes së kufirit, kontrollit të qëndrimit dhe lëvizjes së të huajve, luftimin e krimit ndërkufitar, si dhe avancimin e bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për Menaxhimin e Integruar të Kufijve (MIK). Si rezultat i bashkëpunimit dhe bashkërendimit të aktiviteteve, autoriteteve të MIK-ut, kufijtë e Republikës së Kosovës i kanë kaluar: 27,301,856 persona, që krahasuar me vitin e kaluar tregojnë ngritje për 17.35%; 7,887,764 mjetet motorike, që tregojnë ngritje për 4.25% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ndërsa rënie për 100% e trenave.

Në kuadër të kontrollit të hyrje-daljeve të personave në pikat kufitare janë evidentuar dhe janë procesuar 6,644 persona të rëndësishëm (VIP). Sa i përket kontrollit të vijës së dytë, pjesëtarët e Policisë së Kosovës, në përputhje me parimet e MIK-ut, kanë arritur që të kontrollojnë:

**Tabela nr. 1: Kontrolli i vijës së dytë.**

| Kategoritë | Viti 2022 | Viti 2023 | %      |
|------------|-----------|-----------|--------|
| Persona    | 47,161    | 37,341    | -10.82 |
| Automjete  | 35,912    | 28,248    | -21.34 |
| Dokumente  | 15,418    | 11,649    | 24.44  |



Gjatë ofrimit të sigurisë së kufijve të Republikës së Kosovës, si rezultat i shkeljeve të ndryshme ligjore, pjesëtarët e Policisë së Kosovës kanë hapur 548 raste të veprave penale, 238 kundërvajtje, kanë shqiptuar 1,191 gjoba për kundërvajtje në fushën e migrimit dhe të të huajve. Policia Kufitare ka arrestuar 593 persona për vepra të ndryshme kriminale, 1,571 persona me urdhëresa vendore dhe ka ndaluar 27 persona.

Me qëllim të përmbushjes së objektivave të parapara për periudhën raportuese, zyrtarët e Policisë Kufitare kanë bërë 1,097 inspektime në fushën e migrimit të të huajve, 3,432 refuzime të hyrjes, 636 refuzime të daljes, si dhe kanë realizuar 2,249 verifikime të kërkesave për viza të Republikës së Kosovës. Po ashtu, zyrtarët e Policisë Kufitare kanë ekzekutuar 13 depërtime, 26 urdhër-largime me forcë, 189 urdhër-largime vullnetare dhe kanë trajtuar 179 kërkesa për azilkërkues.

Policia Kufitare gjatë kësaj periudhe ka realizuar 65 operacione dhe 320 patrullime të përbashkëta me shtetet fqinje (Shqipërinë, Maqedoninë dhe Malin e Zi).

Sa i përket menaxhimit të integruar të kufirit janë realizuar: 49 takime të punës brenda Policisë, 52 takime me autoritetet e MIK-ut, ndërsa 107 aktivitete kanë qenë me karakter ndërkombëtar.

Gjatë kësaj periudhe, Policia e Kosovës ka qenë po ashtu e angazhuar në zbatimin e vendimit të ministrit të MPB-së nr.: 0612/2022, lidhur me masat reciproke për targat e Republikës së Serbisë, ku obligohet pajisja me targa të përkohshme të RKS-së, për të gjitha automjetet që mbajnë targat e Republikës së Serbisë që hyjnë në territor të Republikës së Kosovës.



## BURIMET NJERËZORE

Policia e Kosovës përbëhet nga 8,817 punonjës, prej të cilëve 7,949 janë zyrtarë policorë, ndërsa 868 staf civilë. Nga ky numër 85.21% e personelit të Policisë i takojnë gjinisë mashkullore, ndërsa 14.79% gjinisë femërore, prej të cilëve 90.80% janë shqiptarë, ndërsa 9.20% iu takojnë komuniteteve të tjera.

Struktura e re organizative është nënshkruar nga drejtori i përgjithshëm dhe aprovuar nga ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme më 24 mars 2023.

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e vazhdimësisë së saj, Policia është e përkushtuar për rekrutimin, punësimin, trajnimin dhe zhvillimin profesional të individëve të kualifikuar për t'i shërbyer komuniteteve tona si zyrtarë policorë të Policisë së Kosovës. Gjatë vitit 2023 Policia përfundoi procesin e punësimit të 864 zyrtarëve policorë, nga të cilët 108 zyrtarë i përkasin komuniteteve pakicë. Bazuar në konkursin e përgjithshëm për zyrtarë policorë të shpallur në korrik të vitit raportues, në proces është gjenerata e 59-të e cila do të fillojë trajnimin në AKSP gjatë muajit janar të vitit 2024 me gjithsej 450 kandidatë për zyrtarë policorë.

Me gjithë përpjekjet e suksesshme që rezultuan në punësimin e 864 kandidatëve të rinj, Policia humbi 279 zyrtarë policorë dhe staf civilë duke përfshirë daljen në pension dhe dorëheqjen.

Megjithëse punësimi po kthehet në rritje, mbajtja e personelit mbeti një sfidë për Policinë në vitin 2023.

Megjithatë, Policia po vazhdon rekrutimin e gjeneratave të reja dhe është e përkushtuar në adresimin e këtyre sfidave në mënyra të reja dhe inovative.

Për angazhimin e dalluar të pjesëtarëve të Policisë janë ndarë: 548 medalje për "Shërbim të Besnikërisë", 1 medalje "Mburojë e Policisë", 4 medalje për "Shërbim të dalluar", 13 medalje për "Lëvdim", 97 lëvdata dhe 17 mirënjohje nga drejtori i përgjithshëm.

Trajnimi është themeli i performancës aktuale dhe të ardhshme të Policisë. Organizimi i trajnimeve në detyra specifike dhe zhvillim të karrierës siguron që Policia të mbajë performancën me standardet më të larta profesionale. Andaj, Policia gjatë këtij viti përkundër angazhimeve të mëdha operationale, ka arritur të organizojë dhe të administrojë gjithsej 1,331 trajnime, që krahasuar me vitin 2022 tregon ngritje për 12.31%. Nga Divizioni i Trajnimeve janë realizuar: 289 trajnime për 5,661 pjesëtarë të saj dhe 221 ricertifikime për 2,599 zyrtarë policorë. Në bashkëpunim me organizata të tjera janë organizuar 492 trajnime për 4,879 pjesëtarë të saj. Ndërsa, jashtë vendit janë organizuar 324 aktivitete (trajnime, takime, konferenca) për 729 zyrtarë policorë. Gjatë kësaj periudhe Divizioni i Trajnimeve ka organizuar 5 trajnime për organizatat e tjera, në të cilat kanë marrë pjesë 99 pjesëmarrës.



Është hartuar dhe miratuar Rregullorja për Organizmin dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Policinë e Kosovës si dhe Rregullorja për Klasifikimin e Pozitave të Stafit civil në Policinë e Kosovës, e miratuar nga ministri i Punëve të Brendshme.

Shëndeti i personelit policorë është në fokus të vazhdueshëm të organizatës. Me qëllim që të identifikohen, adresohen dhe parandalohen sëmundjet dhe dukuritë e tjera psiko-emocionale në Policinë e Kosovës, gjatë këtij viti është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit me SHSKUK-në, me qëllim të bashkëpunimit për ofrimin e shërbimeve mjekësore dhe psikologjike për personelin policor (përfshirë zyrtarët policorë, stafin civilë dhe kadetët), si dhe ka filluar kontrollimi sistematik për zyrtarët e PK-së nëpër spitalet përkatëse rajonale.

Në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit në mes të Policisë dhe Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës për ekzaminimin mjekësor sistematik të personelit policorë, gjatë kësaj periudhe janë ekzaminuar 1,055 zyrtarë policorë të grupmoshës 50-59 vjeçare, ndërkaq janë realizuar 279 ekzaminime mjekësore psikologjike për rekrut, aplikues të NJSI-së, NJSO-së dhe NJMA-së si dhe 104 ekzaminime mjekësore të avancuara (MRI- rezonancë magnetike).

Gjatë kësaj periudhe ekipi mjekësor dhe Ekipi për Këshillim dhe Përkrahje i DSHSH-së kanë mbajtur: 266 seanca psikologjike, 114 rivlerësime, 36 raste të reja dhe 28 komisione mjekësore. Gjithsej përkrahje mjekësore është ofruar për 6,911 pjesëtarë të Policisë. Ndërsa, në bashkëpunim me Klinikën e Psikiatrisë (SHSKUK) është realizuar fushata vetëdijësuese “Parandalimi i vetëvrasjes” nëpër të gjitha drejtoritë rajonale të PK-së. Po ashtu, në bashkëpunim me QKTGJ-në, është realizuar aksioni humanitar “Dhurimi vullnetar i gjakut”, nëpër të gjitha drejtoritë rajonale të PK-së. Ekipet mjekësore të DSHSH –së, së bashku me katër ekipe mjekësore të Qendrës së Mjekësisë Urgjente të Prishtinës kanë qenë të angazhuar për asistim mjekësorë në Mitrovicë të Veriut.





## SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Për të përmbushur të gjitha këto obligime me sukses, Policia e Kosovës, për vitin 2023 ka pas në dispozicion buxhetin prej 159,736,292.89€, të cilin e ka realizuar në masë prej 98%. Për paga e punonjësve të Policisë janë shfrytëzuar shuma prej 106,300,23.80€, ndërsa shuma e përgjithshme e të hyrave për këtë periudhë kohore ka qenë 17,097,745.79€. Brenda kësaj periudhe janë iniciuar 169 projekte të prokurimit, prej të cilëve 131 kanë qenë për furnizim, 30 për shërbim, ndërsa 8 për punë.

Gjatë kësaj periudhe janë realizuar disa projekte të ndërtimit, si: a) lëshimi në punë i ndërtimit të largpërçuesit në pikën e antenave – Budakovë; b) ndërtimi i garazhit për automjete në kampin Vrella; c) renovimi i objektit nënstationi policor Janjevë; d) renovimi i stacionit policor- Graçanicë; etj. Ndërsa projektet që janë duke i zhvilluar punimet janë: a) ndërtimi i objektit SP Hani i Elezit; b) Ndërtimin e katit dhe renovimi i objektit e PTC-së; c) ndërtimi i depos së eksplozivit në QNJS ‘Ever Zymeri’; d) ndërtimi i murit në stacionin policor në Skenderaj.

Policia e Kosovës rëndësi të veçantë i ka kushtuar zhvillimit të modernizimit të teknologjisë informative si dhe zgjerimit dhe mirëmbajtjes së sistemeve të komunikimit dhe menaxhimit të informacionit në përputhje me Planin Strategjik të Zhvillimit për 2016-2023. Në kuadër të Teknologjisë Informative dhe Komunikimit (TIK) janë vazhduar aktivitete të orientuara në ofrimin e qëndrueshmërisë: a) Sistemi i Integruar Informativ i Policisë (SIPK); b) Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Resurseve të Policisë (PRIMS); c) Sistemi i Menaxhimit të Kufijve (BIMS); d) Sistemi i kamerave të sigurisë; e) Digjitalizimi i radio komunikimit; f)

Zgjerimi i kapaciteteve të infrastrukturës së rrjetit të Policisë; g) Avancimi i Sistemit të Telefonisë - VOIP Avancimi i Sistemit të Linjave Emergjente 192.

Gjatë këtij vitit Policia e Kosovës është furnizuar me 153 automjete: 122 automjete të reja dhe 31 automjete donacion i ri.



# DISIPLINA DHE KONTROLLI I BRENDSHËM

Për të siguruar një qasje profesionale në zbatim të ligjit, Policia e Kosovës monitoron, kontrollon dhe heton veprimet e zyrtarëve të saj. Si rezultat i kësaj kontrole të brendshme gjatë kësaj periudhe Drejtoria për Hetime të Brendshme dhe Verifikim të së Kaluarës ka administruar 984 lëndë disiplinore, prej tyre 663 lëndë të hapura gjatë vitit 2023 dhe 321 lëndë të bartura nga vitet paraprake. Gjatë kësaj periudhe janë përfunduar gjithsej 537 lëndë, prej të cilave 274 kanë qenë të bazuara dhe 445 të pa bazuara/të pa argumentuara.

Në Komisionin e Brendshëm Disiplinor janë pranuar 274 lëndë dhe janë shqyrtuar 262 lëndë. Janë nxjerrë 526 vendime disiplinore, nga të cilat: 25 raste të ndërprerjes së marrëdhënies së punës; 119 raste ndalesë në pagë mujore bruto për shkelje të rëndë; 2 transfere disiplinore; 40 raste ndalesë në pagë mujore bruto për shkelje të lehtë; 76 vërejtje me shkrim; 20 vërejtje me gojë; 13 raste është përgjegjësi për shkelje disiplinore dhe lirohet nga shqiptimi i masës disiplinore.

Komisioni i Ankesave ka pranuar 506 ankesa, ndërsa ka shqyrtuar 512 ankesa, prej të cilave: 330 ankesa janë refuzuar; 46 ankesa kanë qenë të pabazuara; 61 ankesa kanë qenë pjesërisht të aprovuara; 43 lëndë janë kthyer në plotësim të hetimeve/rishqyrtim dhe rivendosje, ndërsa 32 ankesa janë hedhur poshtë pasi që janë parashtruar jashtë afatit, është tërhequr nga ankuesi, i pabazuar apo ankesa nuk ka përmbajtur arsye të mjaftueshme.

Kontrolli i brendshëm i Policisë është fuqizuar edhe me auditimet dhe inspektimet e brendshme. Si rezultat i kësaj kontrole, gjatë periudhës raportuese, Zyra e Auditimit në kuadër të Policisë ka realizuar 11 auditime të rregullta, për të cilat janë dhënë 45 rekomandime. Këto auditime janë bërë në fusha të ndryshme të zbatimit të ligjeve dhe akteve nënligjore që lidhen me fushën e prokurimit, financave dhe menaxhimit të pasurisë, si dhe në fushën e zbatimit të procedurave administrative për personelin e Policisë.

Në kuadër të inspektimeve të brendshme, Policia ka realizuar 48 inspektime të rregullta si dhe 24 inspektime të jashtëzakonshme në të gjitha fushat e inspektimit të punës së Policisë. Për të gjeturat e këtyre inspektimeve janë dhënë 127 rekomandime në fushën e: (a) Inspektimit të administrimit të rasteve policore të dhunës në familje (b) Inspektimi i evidencave dhe veprimeve policore ndaj personave të shpallur në kërkim sipas urdhërarresteve dhe letërreshtimeve të lëshuara nga organet kompetente; (c) Inspektimi i kontrollit dhe mbikëqyrjes së kufirit shtetëror nga Policia Kufitare; (d) Inspektimi imenaxhimit të personelit policor në aspektin shëndetësor.

# BASHKËPUNIMI ME PUBLIKUN - MEDIAT

Policia e Kosovës ka qenë vazhdimisht e përkushtuar në ngritjen dhe forcimin e bashkëpunimit me publikun, mediumet elektronike dhe të shkruara, me qëllim të rritjes së transparencës për veprimet policore. Deri tani ka arritur të krijojë model të informacionit përmes: komunikatave ditore, raporteve ditore, javore, mujore, vjetore, raporteve sipas rastit dhe përmes konferencave për shtyp e edhe përmes informacioneve të shkurtra të përcjella me fotografi – fotolajme.

Gjatë këtij viti janë pranuar 154 kërkesa për qasje në dokumente publike dhe janë organizuar 14 konferenca për medie, të cilat janë mbajtur me rastin e ngjarjeve të jashtëzakonshme. Gjithashtu ka mbështetur dhe ka promovuar disa fushata sensibilizuese në interes të përgjithshëm shoqëror, në fushën e sigurisë rrugore, armëmbajtjes pa leje, përdorimit të dhunës etj. Mund të veçojmë edhe realizimin e disa fushatave sensibilizuese e video-spotëve televizive kryesisht me ndihmën e KFOR-it dhe me ndihmën e OSBE-së.

Në kuadër të DIMP-it e nën menaxhim të web faqes dhe dizajnit funksionon edhe faqja zyrtare e PK-së në Facebook, përmes së cilës janë pranuar informacione relevante si dhe ka pasur disa raste të zgjidhura nga PK-ja të cilat janë raportuar pikërisht në Facebook, si:

- konfiskim armësh ilegale dhe arrestime të kryesve të veprave penale,
- bllokim në trafikun rrugor,
- vjedhje e grabitje të xhiruara e të shpërndara te ne,
- dhunë të llojeve të ndryshme etj.

## Gjatë periudhës raportuese në nivel qendror dhe lokal të Policisë:

- janë lëshuar 2,130 komunikata me shkrim për media;
- janë publikuar 365 raporte 24-orëshe;
- janë publikuar 2,233 aktivitete të ndryshme policore në rrjetet sociale të Policisë;
- janë dizajnuar dhe janë publikuar 70 dokumente si: plane, fushata vetëdijësuese, posterë etj.
- është hartuar dhe është publikuar revista e Policisë së Kosovës 'MBROJTËSI'.



## Kontakto Policinë e Kosovës

---



[www.kosovopolice.com](http://www.kosovopolice.com)



[www.facebook.com/KosovoPolice](https://www.facebook.com/KosovoPolice)



[twitter.com/Kosovo\\_Police](https://twitter.com/Kosovo_Police)



[info@kosovopolice.com](mailto:info@kosovopolice.com)



Aplikacioni lajmëro Policinë